[Shqiptarja.com]

E martë 1 Prill 2025 - Përditësimi i fundit 21:41

Kërko

LIVE Shqiptarja.tv

HOME EDICIONET LOKALE KRONIKË POLITIKË SHËNDETI EKONOMI SPORT KOSOVË & RAJONI BOTË KULTURË EDITORIAL OPINION

TË FUNDIT SOCIALE DREJT PUNËS SPECIALE LAJME TË MIRA LIFESTYLE VIP & SPEKTAKËL RECETA HOROSKOPI DOSJE FOTOGALERI VIDEOGALERI PIKË E ZEZË SONDAZHE

POP 5 Kujtoni me 5 fotografitë e fundjavës si fëmijë!

1 Habit Belisha: Themelet e shtëpisë së Ramës janë si çdo shtëpi, ka bodrum dhe kundërshtë me tjetër

2 Pesaqeni pëtrijtë të hapë derën e avionit me 'si fluturimi ishte orjoni'

3 Nën dyshim për korrupsion, SPAK heton 4 drejtorë dhe 2 ish-ata kërkohet prokurorët

Ellasari Pushon çështjen pas një vit

4 16-vjeçari i aeroportit emërohet NATO, Begaj: Krenohemi me suksesin tuaj me shqiptarët botës

Forcojnë partneritetin me aleatët! Vëngu: Reagimin me vërtetë

5 Milani zgjedh drejtorin e ri sportiv, në gatë sahw edhe Igi Tare

Kronikë

Po trafikonin 2 armë nga Kosova në Tiranë për 10 mijë euro, dy në pranga! Blutë i ndoqën nga Morina, pistoletat prodhim belg (VIDEO)

2 shqiptarë të Kosovës u arrestuan pasi tentuan të trafikojnë 2 pistoleta prodhim belg në Tiranë për t'i shitur 10 mijë euro. Ata u ndoqën dhe kapën nga policia në autostradën Lezhë-Fushë Krujë. Njëri prej tyre rezulton i dënuar në Zvicër për trafik droge.

- VIDEO/ Momenti kur ndërhyn policia, ja ku i fshehën armët
- FOTOT/ Ja kush janë dy të arrestuarit! Njëri i dënuar në Zvicër për trafik droge

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Sokol Dema
1 Prill, 09:32 | **Përditësimi: 1 Prill, 16:22**

Share

TIRANË- Dy shqiptarë të Kosovës u arrestuan për trafik armësh. Në pamje shihet momenti kur agjentë të policisë ndërhyjnë në një pikë karburanti në autostradën Lezhë-Fushë Krujë, pasi aty ndaloi një makinë tip "Volkswagen" me targa kosovare, në të cilën dyshohej se fshiheshin armë.

Policia e ndoqi makinën ngjyrë gri që prej momenteve që kaloi pikën kufitare të Morinës, pasi kishin marrë informacion se do të niseshin drejt Tiranës me qëllim trafikimin e armëve. Në të udhëtonin 2 persona, të cilët u arrestuan pasi në pjesën e përparme të makinës u gjetën 2 pistoleta. Trafikantët ishin munduar t'i fshehin mirë poshtë kofanos së makinës, por gjatë kontrollit u gjetën dhe sekuestruan.

Bëhet fjalë për 2 pistoleta prodhim belg i viteve të fundit, me njërën prej tyre model i veçantë. Me një pistoletë të njëjashme belge, e cila ka nisur të prodhohet që në 1912-ën, u vra Arqiduka Franz Ferdinand i Austrisë më 28 qershor 1914, në Sarajevë, çfarë çoi në shpërthimin e Luftës së Parë Botërore.

Sh.com

LEXO EDHE:
Ambasada Amerikane për rikthimin i ekspertëve të OPDAT në SPAK: Disa programe, thelbësore për interesat kombëtare të SHBA-ve!

Të dy pistoletat, sipas policisë, do të shiteshin në Tiranë me një çmim prej 10 mijë eurosh. 2 të arrestuarit nuk janë treguar bashkëpunues me policinë, pasi në seancën e marrjes në pyetje nuk kanë pranuar të tregojnë ku do i shisnin armët.

> *"Vihen në pranga 2 shtetas kosovarë të cilët dyshohet se i kanë trafikuar 2 pistoletat, me qëllim shitjen në Tiranë, me vlerë afro 10 000 euro. Si rezultat i hetimeve disamujore të kryera me metoda proaktive, në drejtimin e Prokurorisë, për godëljen e veprimtarisë kriminale të shitjes së armëve të zjarrit, Seksioni për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme, në bashkëpunim me Forcën Operacionale të DVP Tiranë, ka organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Suspend", si rezultat i të cilit u arrestuan shtetasit:*
>
> *Altin Pajaziti, 23 vjeç dhe Kadri Prushi, 53 vjeç, të dy banues në Kosovë. Gjatë operacionit, shërbimet e Policisë kanë ndaluar në autostradën "Lezhë - Fushë Krujë", automjetin me të cilin qarkullonin shtetasit Altin Pajaziti dhe Kadri Prushi, në të cilin, gjatë kontrollit, kanë gjetur dhe sekuestruar 2 armë zjarri pistoleta dhe municion luftarak. Nga hetimet dyshohet se këta shtetas i kanë trafikuar pistoletat nga Kosova, me qëllim shitjen në Tiranë", njoftoi policia.*

Njëri prej të arrestuarve, Kadri Prushi, rezulton të jetë dënuar me burg në Zvicër për trafik droge, ndërsa është i skeduar edhe për trafik armësh, nga vende të Europës, në Kosovë, Shqipëri e më gjerë. Policia nuk e përjashton mundësinë e përfshirjes së personave të tjerë në trafik armësh, ndërsa po punohet për identifikimin e tyre.

Dy të arrestuarit Kadri Prushi dhe Altin Pajaziti

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 13:24

Dalin FOTOT/ Ja kush janë dy shqiptarët e Kosovës që u kapën duke trafikuar armë! Njëri i dënuar në Zvicër për trafik droge

Kadri Prushi dhe Altin Pajaziti

Report Tv ka siguruar fotot e dy personave të arrestuar nga Policia e Tiranës, të cilët u kapën duke trafikuar dy armë nga Kosova. Në foto shihni, Altin Pajaziti, 23 vjeç dhe Kadri Prushi, 53 vjeç, të cilët u arrestuan nga policia pasi ishin nisur për të shitur 2 pistoleta në Tiranë.

Prushi, rezulton të jetë dënuar me burg në Zvicër për trafik droge, ndërsa është i skeduar edhe për trafik armësh, nga vende të Europës, në Kosovë, Shqipëri e më gjerë.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

SI.E./I.M/Shqiptarja.com

TAG: Tiranë | trafik armesh | Altin Pajaziti | Kadri Prushi

Komentoj

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
A e keni vendosur se për kë do të votoni më 11 maj?
1 Prill, 10:16

Po | Jo | S'do votoj

Lajme të tjera

Zgjedhjet/ Berisha akuzon Ramën për programin elektoral: E vodhi nga PD-ja! Porosi kandidatëve: Kushti kryesor votat e partisë, pastaj për veten tuaj
1 Prill, 19:24

Zgjedhjet e 11 majit/ Toni Gogu në Report Tv: Synojmë fitoren, mandatin e 20 në Tiranë! PS e angazhuar për anëtarësimin në BE, mbështesim drejtësinë
1 Prill, 19:01

Perla e ditës, Berisha firmos 'kontrata' legalizimi me banorët sikur të ishte kryeministër
1 Prill, 18:36

Kryeministri Rama dhe ministri Gomxhja inspektojnë kantierin e Qendrës së re Kombëtare të Kulturës për Fëmijë: Spektakolare, më e madhja në Ballkan! Ekstravagancë dhe shkencë
1 Prill, 16:20

Akuzat se mori 45 mijë € nga 'Çopjat', Lapaj padit Shehajn për shpifje në SPAK: Sulm i pakuptimtë! Deputeti: Shfaqje për t'iu fshehur aferave me pronat
1 Prill, 14:40

'Rruga Ndroq-Plepa'/ Rama shikon nga afër inspektimet: Një investim që do të zhvillojë ndjeshëm agroturizmin
1 Prill, 13:34

Veliaj: 8 biblioteka të reja në Tiranë, qendra të edukatës dhe debatit
1 Prill, 10:05

Hidhet shorti për Europianin U-17 që do zhvillohet në Shqipëri, kuqezinjtë në 'grupin e ferrit'! E nisim me Portugalinë, në grup Franca dhe Gjermania! Finalja më 1 Qershor

Ernest Koçi

31 Mars, 19:48

Përkujtohet dëshmori i luftës së Kosovës, Indrit Cara! Begaj nga Kavaja: Sakrifica e tij shërben si busull për të ardhmen tonë! I përket gjithë shqiptarisë
31 Mars, 14:48

'Varfëria dhe korrupsioni mund të mposhten', Basha në Njësinë 5: Programi ynë, për një Shqipëri më të drejtë dhe me mundësi për të gjithë
31 Mars, 12:40

Vrasja e palestinezes nga i ati në Tiranë/ Në plan e përfshirë edhe mamaja! Iku nga Gjermania në Liban, gënjyen sikur e reja vdiq në aksident
31 Mars, 12:09

'Na jep 1 mijë euro të të fshijmë fotot private'/ Kërcënuan një person përmes TikTok, arrestohet 27-vjeçari në Tiranë, nën hetim bashkëpunëtorja
31 Mars, 09:52

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i pasaktorizuar i kesaj faqeje